

1. Specifikimet teknike të Naftës (Diesel 10ppm ULSD)

Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), për qëllim transporti sipas standardit:

S SH EN 590:2022 ose ekuivalente

Lëndë djegëse për automjete Gazoil (Diesel 10ppm ULSD)

Standardi S SH EN 590:2022 ose ekuivalent specifikon kërkesat dhe metodat e proves për karburantin Diesel të automjeteve që tregëtohet dhe shpërndahet në treg. Ky standart është i zbatueshëm për karburantin naftë (diesel), i cili përdoret në automjetet e projektuara për të punuar me naftë. Ky standard është në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ku përcaktohen zërat specifikë kimiko - teknik që duhet të plotësohen në mënyrë që ky lloj karburanti të jetë i tregtueshëm dhe të ketë konsum në tregun Shqiptar dhe më gjerë. Për të provuar, kontrolluar dhe verifikuar nëse operatorët ekonomikë ofrojnë në treg naftë (diesel) në përputhje me këtë lloj standardi është e detyrueshme paraqitja e Fletë/Raport analizë lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi. Ky dokument përfshin të gjithë zërat specifikë në zbatim të këtij standardi, ku përcaktohen marzhe minimale dhe maksimale dhe dokumenton përputhshmërinë ose jo përputhshmërinë e karburantit që testohet në kushte laboratorike me këtë standard. Në varësi të rezultatit të Fletë/Raport analizës Autoriteti Kontraktor do të vendosë nëse do të pranojë apo jo karburantin e ofruar nga Operatori Ekonomik.

2. Specifikimet teknike të Benzinës pa plumb (Premium UNL 10ppm)

Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm), për qëllim transporti sipas standardit:

S SH EN 228:2012+A1: 2017 ose ekuivalente

Lëndë djegëse për automjete. Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm)

Standarti S SH EN 228:2012+A1: 2017 ose ekuivalente specifikon kërkesat dhe metodat e proves për karburantin benzinë të automjeteve që tregëtohet dhe shpërndahet. Ky standart është i zbatueshëm për karburantin benzinë i cili përdoret në automjetet e projektuara për të punuar me benzinë. Ky standard është në përputhje me Standardizimit Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ku përcaktohen zërat specifikë kimiko -teknik që duhet të plotësohen në mënyrë që ky lloj karburanti të jetë i tregtueshëm dhe të ketë konsum në tregun Shqiptar dhe më gjerë. Për të provuar, kontrolluar dhe verifikuar nëse operatorët ekonomikë ofrojnë në treg benzinë në përputhje me këtë lloj standardi është e detyrueshme paraqitja e Fletë/Raport analizë lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi.

Ky dokument përfshin të gjithë zërat specifike në zbatim të këtij standardi, ku përcaktohen marzhe minimale dhe maksimale dhe dokumenton përputhshmërinë ose jo përputhshmërinë e karburantit që testohet në kushte laboratorike me këtë standard. Në varësi të rezultatit të Fletë/Raport analizës Autoriteti Kontraktor do të vendosë nëse do të pranojë apo jo karburantin e ofruar nga Operatori Ekonomik.